

The background of the cover is a photograph of the AMF building, a modern multi-story structure with a white facade and large windows. A red flag is flying from a pole in front of the building. In the foreground, there is a small tree with green leaves and a brick-paved area.

Periodik mujor
Nr. 190
Mars 2025

Në
këtë
periodik
do të lexoni:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
organizon tryezë diskutimi
në kuadër të integritit evropian
me përfaqësues të tregut të kapitaleve



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Janar-Shkurt 2025

3

ZHVILLIME TË TJERA

5-8

BOTIME PROFESIONALE

9-11

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

12-13

Autoriteti organizon tryezë diskutimi në kuadër të integrimit evropian me përfaqësues të tregut të kapitaleve



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), organizoi një tryezë diskutimi në kuadër të përafritimit të legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian. Në këtë takim, ku u diskutua mbi ngritjen e skemës së kompensimit të investitorëve në Shqipëri, morën pjesë përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, bankave tregtare në vend, si dhe ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë në fushën financiare.

Diskutohet ngritja e skemës së kompensimit të investitorëve në Shqipëri

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, zj. Mimoza Kaçi, në fjalën e hapjes nënvizoi progresin e bërë në Kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, nën drejtimin e Autoritetit, në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE. Zj. Kaçi riafirmoi angazhimin e plotë institucional për modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës rregullatore në tregjet financiare jobankare, mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin financiar.

Gjatë diskutimeve me grupet e interesit, u theksua rëndësia e ndërtimit të një skeme gjithëpërfshirëse, me mekanizma eficientë dhe fleksibël, për t’iu përshtatur dinamikave të tregut financiar vendas, në funksion të krijimit të një mjedisi investimi transparent dhe të sigurt për investitorin shqiptar.



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar –shkurt 2025


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shkurt 2025 kapën vlerën 3,810 milionë lekë, ose 6.88% më shumë se në janar-shkurt 2024. Gjatë peirudhës janar-shkurtit 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 233,537 me një rritje prej 14.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.53% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.43% dhe risigurimi me 0.041% . Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.79% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.21% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,269 milionë lekë, ose 1.28% më pak se në janar-shkurt 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-shkurt 2025 kapën vlerën 965 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 18.42% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2025 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-shkurtit 2025 arritën rreth 2,294 milionë lekë, ose 12.19% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet ceremonia përmbyllëse e konkursit studentor «Të mësojmë për bursën»



Aktiviteti u konceptua si instrument për nxitjen e edukimit financiar, duke i aftësuar studentët me njohuri praktike mbi funksionimin e tregjeve të kapitalit, investimeve dhe planifikimit financiaror

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me German Sparkassenstiftung Albania organizuan ceremoninë përmbyllëse të konkursit "Të mësojmë për bursën" - *Stock Market Learning Competition 2024*. Aktiviteti u konceptua si instrument për nxitjen e edukimit financiar, duke i aftësuar studentët me njohuri praktike mbi funksionimin e tregjeve të kapitalit, investimeve dhe planifikimit financiar. Në këtë iniciativë, e cila organizohet nga Autoriteti për të katërtin vit radhazi, morën pjesë studentë nga fakultetet ekonomike të universiteteve të ndryshme në vend. Një risi e këtij viti ishte përfshirja e një skuadre me punonjës të AMF-së.

Gjatë ceremonisë, Nëndrejtoresha Ekzekutive e AMF-së zj. Merita Gurabardhi u shpreh se aktivitete të tilla janë një mundësi për të rinjtë që të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike në një mjedis të sigurt dhe transparent.

I pranishëm në këtë aktiviteti, Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri z.Karlfried Bergner, përgëzoi studentët shqiptarë për pjesëmarrjen në këtë konkurs, krahas të rinjve nga e gjithë Europa, dhe i inkurajoi ata të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e tregjeve financiare.

Zhvillohet ceremonia përmbyllëse e konkursit studentor «Të mësojmë për bursën»

... vijon

Në konkurs morën pjesë 32 skuadra studentore nga 15 universitete të ndryshme në vend, të cilët u angazhuan për katër muaj në platformën virtuale të bursës. Studentët patën mundësinë të krijojnë portofolet e tyre të investimit në tituj, duke përdorur çmimet reale të tregtimit në tregjet financiare ndërkombëtare. Në përfundim të konkursit, gjashtë skuadra studentore u shpallën fituese të çmimeve promovuese.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbetet i angazhuar në organizimin e aktiviteteve që synojnë rritjen e edukimit dhe përfshirjes financiare, në përputhje me strategjinë e tij institucionale.



Në konkurs morën pjesë 32 skuadra studentore nga 15 universitete të ndryshme në vend, të cilët u angazhuan për katër muaj në platformën virtuale të bursës.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për sigurimin e Jetës të lidhur me pjesëmarrjen në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", lidhur me klasën 21, "Sigurimi i jetës në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive", sipas seksionit B, aneksi I, të Ligjit 52/2014, ka hartuar projektregulloren "Për sigurimin e jetës të lidhur me pjesëmarrjen në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike".

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm:

Projektregullore "Për sigurimin e jetës të lidhur me pjesëmarrjen në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike"
<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=10114>

Projektregullorja
gjendet në faqen
web në:
[https://amf.gov.al/
projekt.asp?id=1
0114](https://amf.gov.al/projekt.asp?id=10114)

Ekspertë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ishin pjesëmarrës në Tryezën e Rrumbullakët mbi Stabilitetin Financiar dhe Rritjen Ekonomike



Autoriteti vijon angazhimin aktiv në forume akademike dhe profesionale për të ndarë ekspertizën mbi mbikëqyrjen financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë në Tryezën e Rrumbullakët "Balancimi i Stabilitetit Financiar dhe Rritjes Ekonomike: Roli i Rregulloreve të Bazelit në BE," të organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në UET, në bashkëpunim me Jean Monnet Chair.

Zj. Marsela Vaska përfaqësoi Autoritetin duke prezantuar perspektivën e mbikëqyrjes financiare dhe ndikimin e direktivave të BE në tregjet financiare dhe rëndësinë e një kuadri të qëndrueshëm rregullator në tregun financiar jobankar.

Autoriteti vijon angazhimin aktiv në forume akademike dhe profesionale për të ndarë ekspertizën mbi mbikëqyrjen financiare dhe për të kontribuar në zhvillimin e tregjeve financiare në përputhje me direktivat europiane dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

IOSCO paraqet Programin e Punës për vitin 2025. Fokusi kryesor në mbrojtjen e investitorëve dhe stabilitetin financiar



Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) prezantoi sot Programin e saj të Punës për vitin 2025, duke përshkruar prioritetet kryesore në rritjen e elasticitetit financiar, efektivitetit të tregut dhe mbrojtjes së investitorëve në tregjet globale.

Jean-Paul Servais, Kryetar i Bordit të IOSCO-s dhe Kryetar i FSMA-së së Belgjikës, tha: "IOSCO mbetet e përkushtuar për të mbështetur anëtarët e saj për çështjet të ndërlidhura me ta, duke punuar në bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare për të adresuar sfidat globale dhe për të mbështetur përafrimin më të madh në qasjet rregullatore. Ky bashkëpunim është thelbësor për të nxitur përgjigje efektive ndaj rreziqeve të reja në tregjet financiare.

Programi i plotë i punës i IOSCO-s gjendet në:

[OR/01/2025 IOSCO 2025 Work Program](#)

Forcimi i qëndrueshmërisë financiare

IOSCO do të vazhdojë t'i japë përparësi çështjeve që lidhen me financimin e bazuar në treg (i referuar gjithashtu si ndërmjetësimi financiar jobankar ose NBFI), në bashkëpunim të ngushtë me Bordin e Stabilitetit Financiar (FSB). Kjo përfshin kontributin e vazhdueshëm të IOSCO-s në punën e FSB-së në adresimin e çështjeve që lidhen me disponueshmërinë, përdorimin dhe cilësinë e të dhënave jobankare. Për më tepër, IOSCO do të finalizojë Rekomandimet e saj të Rishikuara dhe Udhëzuesin e Zbatimit shoqëruar për menaxhimin e likuiditetit të fondeve të hapura, duke siguruar që ato pasqyrojnë dinamikat në zhvillim të tregut dhe kontribuojnë në një elasticitet më të madh në industrinë e menaxhimit të aktiveve.

... vijon

IOSCO paraqet Programin e Punës për vitin 2025. Fokusi kryesor në mbrojtjen e investitorëve dhe stabilitetin financiar

... vijon

Mbështetja e efektivitetit të tregut

Për të mbështetur integritetin dhe efikasitetin e tregut, IOSCO do të trajtojë rreziqet që lidhen me praktikën para-mbrojtëse të përdorura nga ndërmjetësit e tregut, me qëllim identifikimin e dobësive të mundshme dhe sigurimin e praktikave të drejta të tregut. IOSCO do të rishikojë gjithashtu edhe Parimet e saj për Vlerësimin e Skemave të Investimeve Kolektive, duke marrë parasysh rëndësinë në rritje të aseteve private në industrinë e menaxhimit të aseteve.

Mbrojtja e investitorëve

Pas publikimit të Udhërrëfyesit për Sigurinë Online të Investitorëve me Pakicë, IOSCO do të ndërmarrë veprime që synojnë trajtimin e rreziqeve që paraqiten nga tregtimi imitues dhe i kopjeve, praktikën e dobëta të angazhimit digjital, konfliktet e mundshme të interesit nga neo-brokerët dhe aktivitetet e influencers (influencuesit e vendimeve financiare nëpërmjet rrjeteve sociale). IOSCO dhe anëtarët e saj do të angazhohen gjithashtu në mënyrë aktive me kompanitë e mediave sociale dhe motorët e kërkimit për të luftuar dëmin financiar në internet kundër investitorëve me pakicë, duke përfshirë lançimin e I-SCAN të IOSCO-s - Portalin e saj të ri të Paralajmërimeve për Investitorët.



Programi i plotë i punës i
IOSCO-s gjendet në:
[OR/01/2025 IOSCO 2025
Work Program](#)



Adresimi i rreziqeve në Financat e Qëndrueshme dhe Fintech

IOSCO do të nisë një iniciativë pilot të Monitorimit të Zbatimit të Aseteve Kripto dhe Dixhitale (CDA), duke bashkëpunuar ngushtë me FSB-në. IOSCO do të zhvillojë më tej punën e saj për përdorimin e Inteligjencës Artificiale në tregjet financiare dhe do të vazhdojë të monitorojë evolucionin e tokenizimit të aseteve në tregjet e letrave me vlerë. Së fundi, duke punuar me Komitetin për Pagesat dhe Infrastrukturat e Tregut (CPMI), IOSCO do të kërkojë të forcojë qëndrueshmërinë operacionale të Infrastrukturave të Tregut Financiar (FMI).

... vijon

IOSCO paraqet Programin e Punës për vitin 2025. Fokusi kryesor në mbrojtjen e investitorëve dhe stabilitetin financiar

... vijon

IOSCO do të punojë së bashku me Bankën Botërore për të mbështetur juridiksionet e interesuara në zhvillimin e tregjeve të karbonit. IOSCO gjithashtu do të zgjerojë analizën e saj të tregjeve të qëndrueshme të obligacioneve dhe indekseve ESG dhe do të kryejë një vlerësim të zbatimit të rekomandimeve lidhur me qëndrueshmërinë për menaxhimin e aseteve.

Promovimi i bashkëpunimit rregullator dhe efektivitetit

IOSCO do të vazhdojë përpjekjet e saj në terren dhe asistencën teknike për të ndihmuar juridiksionet të përmbushin kërkesat e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s (MMoU).

IOSCO do të zgjerojë programin e saj *NEXTGEN (Nurturing Excellence Through Growth, Education, and Networking)*, me plane për të ofruar mbi 40 nisma për ndërtimin e kapaciteteve në vitin 2025.

IOSCO do të vazhdojë të monitorojë aspektet e zbatimit të standardeve të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Qëndrueshmërisë (ISSB) dhe do të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve për juridiksionet e interesuara që kërkojnë t'i miratojnë, zbatojnë dhe përdorin ato standarde. Në veçanti, do të vazhdojë të mbështesë juridiksionet e Tregjeve në Rritje dhe në Zhvillim (GEM) në miratimin e Standardeve të Qëndrueshmërisë ISSB.

Programi i plotë i punës i IOSCO-s gjendet në:
[OR/01/2025 IOSCO 2025 Work Program](#)



IOSCO publishes new Consultation Report on AI in Capital Markets



IOSCO unveils Work Program for 2025

GREQI

www.xprimm.com

Sipas sondazhit të kryer nga Shoqata e Shoqërive të Sigurimeve të Greqisë (AAEE) me anëtarët e saj, vëllimi total i primeve në vitin 2024 u rrit me 8.7% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 5.68 miliardë euro. Më konkretisht:

- Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 9.4%, duke arritur në 2.95 miliardë euro;
- Sigurimet e Jetës u rritën me 7.9%, duke arritur në 2.73 miliardë euro;
- Sigurimet motorike zinin thujse gjysmën e vëllimit të primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës, duke arritur në 1.13 miliardë euro, ose 7.6% më shumë krahasuar me një vit më parë;
- Linjat e sigurimit të pronës arritën në 651.37 milionë euro, me rritje 14.8% më shumë në terma vjetorë;
- Dëmtimet e paguara nga siguruesit grekë në vitin 2024 arritën në 2.17 miliardë euro.

Alexandros Sarrigeorgiou, President i Shoqatës të Shoqërive të Sigurimeve, duke komentuar rezultatet e sondazhit, tha: "Në vitin 2024, trendi rritës i tregut të sigurimeve vazhdoi të shihet në vëllimin e primeve të shkruara bruto, si në sigurimet e përgjithshme ashtu edhe në sigurimet e Jetës. Kishte kërkesë për sigurime në shumë sektorë, me fokus të veçantë në sigurimin e pronës, përgjegjësinë civile, shëndetin dhe skemat e investimeve të lidhura me sigurimin e Jetës. Vlen të theksohet se rritja e tregut të sigurimeve ishte më shumë se ajo e inflacionit, duke konfirmuar rritjen e fortë të sektorit. Ky zhvillim tregon se gjithnjë e më shumë qytetarët e kuptojnë vlerën e sigurimeve si një investim thelbësor për të ardhmen dhe për mbrojtjen e tyre.

Në tregun grek të sigurimeve operojnë 30 shoqëri sigurimesh vendase, 17 degë të sipërmarrjeve të huaja të sigurimeve dhe 3 shoqëri të përbashkëta Panhelenike.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, tregu i sigurimeve në vend u rrit me 14.63% në terma vjetorë, duke arritur vëllimin e primeve të shkruara bruto me vlerë 167.9 milionë euro. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara arritën në 76.60 milionë euro, që është 8.44% më e lartë se në vitin 2023.

Sigurimi i Jetës mbeti në një fazë të hershme zhvillimi, me prime me vlerë 7.6 milionë euro, ose 15.15% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Biznesi i sigurimeve të Jo-Jetës zë 95.5% të primeve totale të sigurimit, duke arritur në 160.3 milionë euro, me 14.6% më shumë se një vit më parë. Më shumë se gjysma e vëllimit të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës (55.4%) vjen nga sigurimi MTPL, me rreth 88.93 milionë euro. Në totalin prej 76.6 milionë euro, vlerë e dëmeve të paguara nga siguruesit kosovarë për segmentin e Jo-Jetës, dëmet e MTPL-së përbëjnë 60%, të vlerës ose rreth 41.16 milionë euro.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të tregut për vitin 2024, të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, kompanitë e sigurimit në vend realizuan një biznes të përgjithshëm për vitin 2024 me vlerë të primeve prej 15.97 miliardë denarë ose rreth 259.7 milionë euro, me rritje 11.3% më shumë se një vit më parë.

Dëmet e paguara nga siguruesit u rritën në vitin 2024 me 7.7%, duke arritur në 6.27 miliardë denarë, ose rreth 102 milionë euro. Pjesën më të madhe të këtyre dëmeve, me vlerë 5.22 miliardë denarë, e zënë pagesat për sigurimet e Jo-Jetës dhe 1.04 miliardë denarë janë nga sigurimet e Jetës.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 10.3% në terma vjetore, duke arritur në 13.07 miliardë denarë, ndërsa primet në segmentin e sigurimit të Jetës arritën në 2.9 miliardë denarë, me një rritje prej 16.3% në vit.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, (TSB), në vitin 2024, sektori turk i sigurimeve u rrit me 72.5% duke arritur në 838.5 miliardë TRY ose 22.78 miliardë euro. Në monedhën evropiane, për shkak të diferencave të kursit të këmbimit, ndryshimi i tregut ishte afërsisht në rritje 53% në terma vjetore.

Sektori i sigurimit të Jetës u rrit me rreth 76.22% në vit, duke arritur në 99.9 miliardë TRY, ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës, u rritën me 72.5%, në terma vjetore, duke arritur në 738.6 miliardë TRY.

Sigurimet shëndetësore kanë rritur peshën e tyre në totalin e tregut me rreth 1.5 pikë përqindje. Ndërsa raportet e tjera mbeten pothuajse e pandryshuara.

Shoqata e Sigurimeve të Turqisë ka 70 anëtarë aktivë, shoqëri të sigurimeve.



Për informacion
të mëtejshëm
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al